



K.DH.SH.II.nr.482/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhoma e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Faton Bajrami kryetar i kolegjit, Saranda Bogaj Sheremeti dhe Franciska Zhitija Ymeri, anëtare, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit "G.V." B.I, me seli ne Suhareke, te cilin sipas autorizimit e perfaqison S.E., avokat ne Prishtine, kundër të paditurës Dogana e Kosovës (DK), në Prishtinë, me bazë juridike, anulim vendimi, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës, ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës-Dhomat e Shkallës së Parë- Departamenti Fiskal, KF.nr.233/2022 të datës 01.02.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 16.04.2024, merr këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pa bazuar ankesa e të paditurës Dogana e Kosovës në Prishtinë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës-Dhomat e Shkallës së Parë- Departamenti Fiskal, KF.nr.402/2022 të datës 23.10.2023, vërtetohet.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Komerciale të Kosovës-Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti Fiskal, KF.nr.233/2022 të datës 01.02.2023, është vendosur si ne vijim:

I. APROVOHET ne tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditësit "G.V." B.I, me seli ne Suhareke, te cilin sipas autorizimit e përfaqëson S.E., avokat ne Prishtinë@.

II. ANULOHET aktvendimi me nr.01.3.2.2/11689/11691 i datës 19.08.2021 i Doganës se Kosovës me seli ne Prishtine.

III. OBLIGOHET e paditura Dogana e Kosovës me seli ne Prishtine, qe paditësit "G.V." B.I, me seli në Suhareke, t'ia kthej shumën prej 7,326.54€ (shtatemije/e/treqind/e/njzetë/e/gashte/euro/e/pesëdhjete/e/kater/centë), te paguar me tepër ne emër te detyrimeve doganore, per shkak te rivlerësimit te mallit te zhdoganuar përmes Deklaratave Unike Doganore me nr. R-42943/10.06.2021, dhe R- 2945/10.06.2021, te procedure ne Zyrën e Brendshme Doganore Prishtine, me kamate ligjore prej 8% nga dita e paraqitjes së padis ne gjykatë 20.09.2021, e deri ne pagesën definitive, ne afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit te këtij aktgjykimi.

IV. Secila palë i bart shpenzimet e veta procedurale.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë e paditura Dogana e Kosovës, për shkak të: shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, zbatimit të gabuar të së drejtës materiale. Me propozim që të aprovohet ankesa në tërësi si të bazuar me ligj, të prishet aktgjykimi KF.nr.233/2022 i datës 01.02.2023 si i pa bazuar me ligj, ta refuzon padinë dhe kërkesëpadinë në tërësi si të pabazuar me ligj dhe të lë në fuqi vendimin e kontestuar si të ligjshëm ose t'ia kthej gjykatës në rishqyrtim dhe rivendosje.

Gjykata Komerciale-Dhoma e Shkallës së Dytë, shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore, përgjigjen në ankesë, dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 49 të LKA, nenit 81.H të Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat nr.03/L-222, lidhur me nenin 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA), gjeti se:

Ankesa është e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se me aktvendimin e kundërshtuar nr.01.3.2.2/11689/11691 i datës 19.08.2021, të Doganës së Kosovës në Prishtinë, është refuzuar si e pa bazuar kërkesa e subjektit në procedurë "G.V." B.I, me seli ne Suhareke, për rishqyrtimin e vendimeve R-42943/10.06.2021, dhe R- 2945/10.06.2021 të ZBD Prishtina. Dhe është lënë në fuqi rivlerësimi i Deklaratave Unike Doganore nr.R-42943/10.06.2021, dhe R- 2945/10.06.2021 të ZBD Prishtina, nga ana e Sektorit të Pranimit Qendror.

Paditësi i pakënaqur me aktvendimin e lartcekur të paditurës Dogana e Kosovës në Prishtinë, ka ushtruar padi për konflikt administrativ me datën 20.09.2021, me pretendim se i njëjti është i pa drejtë dhe i pa ligjshëm.

Dhoma e shkallës së parë-Departamenti Fiskal, pas shqyrtimit të padisë së paditësit paraqitur kundër aktvendimit nr. 01.3.2.2/11689/11691 i datës 19.08.2021 të Doganës së Kosovës në Prishtinë, dhe pas administrimit të provave si në procesverbal të shqyrtimit kryesor, e duke u bazuar edhe në provat dhe dëshmitë e tjera të lëndës, bie aktgjykimin e ankimuar me të cilin kërkesëpadinë e paditësit e aprovon si të bazuar, duke vendosur sikurse në dispozitiv të aktgjykimit. Me arsyetim se Gjykata nga shkresat e lëndës vlerëson se me asnjë provë nuk është provuar konstatimi i të paditurës i dhënë në vendimin e kontestuar, sipas të cilit vlera e deklaruar e mallit lëndor nga paditësi, nuk është çmimi real i paguar i mallit me qëllim importi në vendin tonë për arsye se është deklaruar vlerë më e vogël se sa vlera reale e paguar apo që ka për tu paguar për mallin e shitur për eksport, përkatësisht import në vendin tonë në vështrim të nenit 33 të KDAK-së. Gjykata vlerëson se e paditura pa bazë ligjore dhe prova materiale të besueshme e ka rivlerësuar mallin lëndor të deklaruar për zhdoganim nga paditësi përmes DUD-it nr.R-42943/10.06.2021, dhe R- 2945/10.06.2021 të Zyrës së Brendshme Doganore Prishtina dhe në këtë mënyrë të njëjtin e ka obliguar pa të drejtë me pagesë e detyrimeve shtesë importuese doganore në shumë prej 7,326.54€ mbi vlerën e deklaruar të mallit të importuar. Gjykata konstaton se në rastin konkret paditësi ka paraqitur faturat e mallit lëndor nr.01/05/2021, nr.01/EX/05/21 nr.10854, nr. 22A003, nr.22A004, të cilat janë paguar përmes Urdhërpagesave Ndërkombëtare të datës: 17.05.2021, dt:08.06.2021, të cilat dokumente rezultojnë të jenë të harmonizuara në tërësi sa i përket vlerës së mallit të importuar nga paditësi në kuptim të nenit 33 par.1 të KDAK-së si dhe sa i përket përshkrimit të numrit serik të autobusit. Gjykata cilëson se pretendimet e paditësit janë plotësisht të bazuara dhe të drejta dhe se dokumentacioni i prezantuar nga pikëpamja ligjore për zhdoganimin e mallit lëndor, komfor nenit 33 par.1 të Kodit Doganor dhe Akcizave nr. 03/L-109. Nisur nga kjo gjykata duke vepruar në përputhje me dispozitat e nenit 292 pika b të KDAK-së nr.03/L-109, nenit 46 paragrafi 4 dhe 5 të Ligjit nr.03/L-202 për

Konfliktet Administrative, miratoj kërkesëpadinë e paditësit e anuloi vendimin e kontestuar të paditurës dhe e detyroj të paditurën që paditësit "G.V." B.I, me seli ne Suhareke, t'ia kthej shumën prej 7,326.54€ të paguar më tepër në emër të detyrimeve doganore, për shkak të rivlerësimit të mallit të zhdoganuar përmes Deklaratave Unike Doganore me nr.R-42943/10.06.2021, dhe R- 2945/10.06.2021 të proceduar në Zyrën e Brendshme Doganore Prishtina. Gjykata i ka vlerësuar deklaratimet dhe provat tjera materiale të cilat gjenden në shkresat e lëndës, por erdhi në përfundim se të njëjtat janë pa ndikim në vendosjen ndryshe të kësaj çështje juridike administrative.

Qëndrimin juridik të Dhomës së shkallës së parë, si të rregullt dhe të bazuar në ligj në tërësi e pranon edhe kjo gjykatë, për arsye se aktgjykimi i ankimuar nuk është përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të Ligjit për Konfliktet Administrative, të cilat shkelje gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative. Dhoma e shkallës së parë duke vlerësuar ligjshmërinë e aktvendimit të kontestuar mbështetur edhe në dispozitat nga neni 8 i Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK-së), në drejtim të pretendimeve në padi, në përgjigje në padi, provave të administruara në seancë gjyqësore si dhe pas shqyrtimit të shkresave të tjera të lëndës me të drejtë ka konstatuar se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar.

Sa i përket pretendimeve ankimore të paditurës për shkelje esenciale të dispozitave të procedurës, këto pretendime ankimore nuk qëndrojnë, meqë Dhoma e shkallës së parë ka shqyrtuar padinë, fillimisht i ka dërguar padinë përfaqësuesit të paditurës në përgjigje në padi, pastaj ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesor, ka nxjerrë prova të mjaftueshme, që do të thotë se gjatë vlerësimit gjykata e shkallës së parë nuk ka bërë shkelje esenciale të dispozitave LKA-së, Ligjit Nr.04/L-102 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat, Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës, si dhe të LPK-së.

Ndërsa sa i përket pretendimeve ankimore për vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, se gjykata nuk ka administruar provat për të vërtetuar gjendjen faktike por vetëm i ka përmendur ato dhe ka nxjerr konkluzion të gabuar duke e aprovuar padinë e paditësit. Po ashtu aktgjykimi i atakuar përmban shkelje të dispozitave materiale, respektivisht nenit 34 të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës, pasi që në nenin e përmendur është paraparë se Dogana e Kosovës për vlerën e mallrave të importuara, kur nuk mund të përcaktohet në bazë të nenit 33 dhe 34, çmimet e mallrave do të përcaktohen në bazë të dhënave sipas renditjes kronologjike të nën paragrafëve të dispozitave të KDA-së. Këto pretendime ankimore kolegji i kësaj gjykate nuk i aprovoj, ngase të njëjtat janë të pa argumentuara dhe të pa qëndrueshme në vërtetimin e gjendjes tjetër faktike nga ajo e vërtetuar nga Dhoma e Shkallës së Parë. E paditura me asnjë provë nuk i vërteton pretendimet e saj në ankesë, ndërsa provat e prezantuara nuk janë me ndikim për vendosje ndryshe të kësaj çështje administrative juridike, për faktin se e paditura nuk ka arsyetuar pretendimin se përse vlerësimi nuk mund të bëhet me metodën e parë të vlerësimit në vështrim të nenit 33 të Kodit Doganor dhe Akcizave të Kosovës nr. 03/L-109. Dhoma e Shkallës së Dytë vlerëson se Dhoma e Shkallës së Parë drejtë ka vepruar kur ka konstatuar se e paditura nuk ka dëshmuar me asnjë provë kur me vendimin e kontestuar ka rivlerësuar mallin sipas metodës së gjashtë të vlerësimit me arsyetimin se vlera e deklaruar e

mallit lëndor nga paditësi, nuk është vlera reale e paguar e mallit me qëllim importi në vendin tonë në vështrim të nenit 33 të KDAK-së.

Pra, nga shkresat e lëndës, gjykata me te drejte vlerëson se me asnjë prove nuk është provuar konstatimi i te paditurës i dhënë ne vendimin e kontestuar, sipas te cilit vlera e deklaruar e mallit lëndor nga paditësi, nuk është çmimi real i paguar e mallit me qëllim importi ne vendin tone për arsye se është deklaruar vlere me e vogël se sa vlera reale e paguar apo qe ka për tu paguar për mallin e shitur për eksport, përkatësisht import ne vendin tone ne vështrim te nenit 33 te KDAK-se. Gjikata konsideron se paditura do te mund ta mbështetet një konstatim te këtillë vetem atëherë kur do te mund te siguronte dëshmi konkrete se paditesi per mallin lëndor kontestues i ka paguar eksportuesit mbi mimin neto te fatures te mallit, ku vlera e mallit te faturuar nga eksportuesi she paguar nga paditesi permes Urdherpagesës Ndërkombëtare të dates 17.06.2021 ne shumen prej 20,000.00 € per pro faturat nr. 01/05/21 dhe nr.02/05/21, si dhe dy pagesave bankare te dates 08.06.2021 me nga 5,000.00 € për faturat nr.01/EX/05/21 dhe nr.02/EX/05/21, te cilat jane ne harmoni te plote ne kuptim te shumes dhe pershkrimit te mallit kontestues, të importuar nga paditësi në kuptim të nenit 33 par.1 të KDAK-së. Andaj, duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes, kjo gjykatë gjen se Dhoma e shkallës së parë drejtë ka vendosur kur është bazuar në dispozitat e nenit 46 par. 2, 3, 4 dhe 5 të Ligjit 03/L-202 për Konfliktet Administrative.

Nga tërë kjo që u cek më lartë dhe mbi këtë gjendje faktike, kjo gjykatë konsideron se gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë, ngase nuk është cenuar ligji në dëm të paditurës. Prandaj, pretendimet ankimore në ankesë se Dhoma e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar edhe të drejtën materiale në dëm të paditurës, ky kolegj nuk i aprovoi, sepse vlerësoi se te njëjtat janë të paqëndrueshme dhe të pa bazuara për tu aprovuar ankesa, dhe se janë të pa ndikim në vërtetimin e një gjendje tjetër faktike nga ajo e vërtetuar edhe nga Dhoma e shkallës së parë. Sepse, aktgjykimi i ankimuar i Dhomës së shkallës së parë, është i qartë dhe i kuptueshëm si dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare, të cilat i pranon edhe kjo gjykatë, andaj, ankesa e të paditurës u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm. Duke marrë parasysh se Dhoma e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale dhe materiale, me rastin e aprovimit të kërkesëpadisë së paditësit, e pasi që me pretendimet tjera ankimore të përsëritura, të njëpasnjëshme, një aktgjykim i tillë nuk mund të vihet në pyetje, ankesa e të paditurës, u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm.

Mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 49 të LKA-së, lidhur me nenin 200 të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhoma e Shkallës së Dytë

K.DH.SH.II.nr.482/23, me datë 16.04.2024

**Kryetar i kolegjit,
Faton Bajrami**